



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA E QYTETIT
KORCE

E lidhur sot ne daten 29 /08/2014 midis paleve:

KONTRAKTUESI


NOVATECH STUDIO, Adresa: Tirane, me nr. license profesionale MK 1846/3, rregjistruar me NIPT L01717030C, , i quajtur me poshte mbikqyresi.

AUTORITETI KONTRAKTOR

Bashkia Korce, Rruga " 28 Nentori" perfaqesuar nga Kryetari i saj **Z.Sotiraq Filo**, i quajtur me poshte Investitori.

BAZA LIGJORE

1. Kontrata do te qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise.
2. Kontrata hartohet ne baze te dispozitave ligjore te parashikuara nga nenet 659 e vijues te Kodit Civil, Ligjin 8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", neni 7, ne Udhezimin nr.3 date 15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit "i ndryshuar, si edhe ne Udhezimin Nr 2 date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit"
3. Dokumentacioni i procedures te prokurimit eshte pjese perberese e kesaj kontrate.



Neni 1 Objekti i kontrates:

Objekti i kesaj kontrate eshte : "Supervizion per objektin Projekti "Shkolla,qender komunitare": Terrene sportive ne 4 shkolla te qytetit Korce (shkolla "Demokracia,shkolla "Naum Veqilharxhi",Shkolla "Sotir Gura",kompleksi shkollor Rruga "Ajet Xhindolli").

Neni 2 Vlera e Kontrates:

Vlera e kesaj kontrate eshte **159.996 (njqind e pesedhjte e nente mije e nentqind e nentedhjte e gjashte)lek** , vlere e cila do te perballohet nga te ardhurat e Bashkise.

Neni 4 Qellimi i Kontrates:

Kjo kontrate ka per qellim realizimin e mbikqyrjes se punimeve ne objektin e sipercituar, te mbarevajtjes se te gjithë procesit te zbatimit te punimeve, ne perputhje me projektin , kushtet teknike te projektit te zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit te ndertimit dhe kontraktimit.

Neni 5 Afati

Koha e mbikqyrjes se punimeve lidhet me kohen e zgjatjes se punimeve dhe fillon nga data e lidhjes se kontrates me firmen zbatuese.(Afati i parashikuar i zbatimit te punimeve eshte 90 dite) .

Neni 6 Detyrimet e Paleve

MBIKEQYRESI I PUNIMEVE

1.Mbikeqyresi i punimeve duhet te kryeje sherbimin e kerkuar ne perputhje me Ligjin 8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit , i ndryshuar, Udhezimin Nr 2 date 13.05.2005 "Per zbatimin e punimeve te ndertimit", i ndryshuar,Udhezimin e KM Nr.3 date 15.02.2001 për "Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit", i ndryshuar .

Mbikeqyresi duhet te zbatoje me perpikmeri te gjitha detyrimet e percaktuara ne aktet ligjore te mesiperme.

2. Një kopje e dokumentacionit, e miratuar nga mbikëqyrësi i punimeve, i dërgohet kolaudatorit të objektit.

Mbikëqyrësi i punimeve *merr pjesë në kolaudimin e veprës*, i përgjigjet kolaudatorit me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për kolaudimin e veprës, si dhe firmos procesverbalin e këtij kolaudimi. Situacionet e paraqitura nga sipërmarrësi, në fazat e ndryshme të punimeve kontrollohen dhe miratohen nga mbikëqyrësi i punimeve.

Pagesa mund të kryhet vetëm në bazë të këtij miratimi.

3.Ne perfundim te punimeve te ndertimit, mbikqyresi i punimeve duhet *te pergatise nje raport te gjere*, te shoqeruar me relacione teknike qe pasqyrojne ngjarje te vecanta te shfaqura gjate periudhes se ndertimit.



4. Mbikëqyrësi i punimeve do të jetë përballë investitorit tërësisht teknikisht, administrativisht dhe juridikisht përgjegjës për mbikqyrjen e punimeve të realizuara sipas kontratës së sipërmarrjes.

PALA INVESTITORE

1. Investitori merr përsipër të pajisë sipërmarrësin dhe njëkohësisht dhe mbikëqyrësin e punimeve me dokumentacionin e nevojshëm i cili do të shërbejë atij për kontrollin e punimeve.
2. Të vejë në dijeni mbikëqyrësin e punimeve për nenkontraktoret e mundshëm që mund të zgjedhë investitori.
3. Të vejë në dijeni mbikqyrësin e punimeve për çdo ndryshim të mundshëm.
4. Të kryejë pagesat kundrejt mbikëqyrësit të punimeve sipas cmimit të përcaktuar në kontratë .
Pagesa do të kryhet në Raiffeisen Bank, me Nr llogarie 0001260342 IBAN AL60202110130000000001260342.
Pagesa e mbikëqyrësit do të bëhet në masën 90% pas aktit të kolaudimit dhe 10% pas marrjes në dorezim të objektit.

Neni 7 Zgjidhja e kontratës

Investitori mund të zgjidhë kontratën nëse mbikëqyrësi nuk zbaton detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë dhe detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore në fuqi.

Neni 8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Investitori dhe mbikëqyrësi i punimeve duhet bëjnë çdo përpjekje për të zgjidhur në mënyrë paqësore nëpërmjet bisedimeve të drejtperdrejta çdo mosmarrëveshje që lind midis tyre ose lidhur me kontratën.
2. Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Korçë.

Kjo kontratë u hartua në pesë kopje nga të cilat një për Dosjen e Prokurimit, një për Drejtorinë e Menaxhimit të Kontratave, një për Mbikëqyrësin e Punimeve, një për Drejtorinë e Financës dhe tjetra për Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Teritorit

KONTRAKTUESI

NOVA TECH STUDIO



AUTORITETI KONTRAKTOR

BASHKIA KORÇE

KRYETARI

SOTIRAQ FILO

